



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1911 / prot.,
5

Tiranë, më 04.07.2019

VENDIM

Nr. 40, datë 04.07.2019

PËR

**MIRATIM E NUMRIT TË PERSONELIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË,
NË TË GJITHA NIVELET**

Në bazë të nenit 49 gërma “ç”, nenit 129 gërma “c” të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative, në institucionet e arsimit të lartë”, në vijim të propozimit të Senatit Akademik me Vendimin nr. 12, datë 11.02.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, dhe të Vendimit të Senatit Akademik nr. 28, datë 28.02.2019 dhe të Vendimit nr. 42, datë 16.06.2019 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 12, datë 11.02.2019 “Për miratimin e strukturës organizative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, të shkresave të Administratorit nr. 782/2 prot., datë 13.03.2019 “Efektet financiare të strukturës së propozuar të UMT” dhe nr. 782/3 prot., datë 01.07.2019 “Mbi ndryshimet në efektet financiare të draft strukturës së propozuar”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë numrin e personelit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në të gjitha nivelet e tij.
2. Numri i personelit është i ndarë sipas njësive shpenzuese referuar tabelave bashkëlidhur dhe pjesë integrale e këtij vendimi.
3. Ngarkohen të gjitha strukturat e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËS KRYETARI

Florian TOTI